

**KARTË DHURATË ("GIFT CARD") NGA ZARA
KUSHTET E PËRGJITHME TË PËRDORIMIT**

1. Karta Dhuratë (tani e tutje referuar si "Karta") është pronë e lëshuesit "ITX Kosovo" L.L.C. me NUI 810101577 në Zona e Re Industriale, Veternik, ALBI Mall, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës (tani e tutje referuar si "ZARA"). Mbajtësi i Kartës është thjesht depozitues.
2. Karta është ekskluzivisht e vlefshme në Kosovë për blerjen e produkteve që shiten në ndonjë dyqan ZARA apo përmes www.zara.com/xk.
3. Çmimi i Kartës mund të paguhet me çdo mjet pagese të pranuar në dyqanet ZARA apo përmes www.zara.com/xk.
4. Kthimi i ndonjë Kartë e cila nuk është përdorur ende do të pranohet brenda kushteve në vijim:
 - 4.1 Kartat e blera në ndonjë dyqan ZARA mund të kthehen brenda 30 ditëve nga data e blerjes.
 - 4.2 Kartat Fizike të blera nëpërmjet www.zara.com/xk mund të kthehen brenda 30 ditëve nga data e konfirmimit elektronik (me e-mail) të transportit.
 - 4.3 Kartat Virtuale të blera nëpërmjet www.zara.com/xk mund të kthehen brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të Kartës virtuale nga ZARA te marrësi i synuar i saj.

Shitja e këtyre formateve të ndryshme të kartave do të jetë subjekt i disponueshmërisë së tyre në Kosovë.

Çmimi i paguar për Kartën do të rimbursohet duke përdorur të njëjtat mjete pagese që janë përdorur për blerjen e saj. Për një rimbursim të tillë, kuponi i shitjes ose fatura elektronike, dhe, ku është e përshtatshme kartela e pagesës si dhe fatura e pagesës duhet të prezentohen. Kthimi i ndonjë Kartë të blerë në ndonjë vend tjetër nuk do të pranohet.

Çdo shumë e pashfrytëzuar e Kartës nuk do të rimbursohet, ose të këmbehet me para në dorë.
5. Karta mund të përdoret sa herë që mbajtësi i saj dëshiron, derisa shuma totale të jetë shfrytëzuar.
6. Bilanci i mbetur në Kartë tregohet në arkë çdo herë që bëhet blerja me Kartë për blerjet e bëra në çdo dyqan ZARA, ose në informacionin e dhënë pas vendosjes së një porosie për blerjet e bëra nëpërmjet www.zara.com/xk. Bilanci i mbetur i Kartës mund të kontrollohet në secilin dyqan të ZARA-s, ose në www.zafra.com/xk. Kur çmimi i blerjes është më i lartë se bilanci i mbetur në Kartë, diferenca mund të paguhet përmes çfarëdo mjeti pagese të pranuar në dyqanet ZARA-s ose në www.zara.com/xk, sipas rastit.
7. Produktet e blera me Kartë në cilindo dyqan të ZARA-s do t'i nënshtrohen kushteve të përgjithshme të blerjes si çdo produkt tjetër i blerë në dyqanet e përmendura. Produktet e blera me Kartë nëpërmjet www.zara.com/xk do t'i nënshtrohen termave dhe kushteve të paraparur në webfaqen e përmendur.
8. Nëse është e përshtatshme, rimbursimi për produktet e blera me Kartë dhe të cilat kthehen do të bëhet nga ZARA duke e kredituar çmimin e produktit të kthyer në bilancin e mbetur të

Kartës ose kur Karta nuk ekziston më pas kthimit të produkteve, duke e kredituar çmimin e produktit të tillë në Kartën e Voucher lëshuar nga ZARA (i) që do të shpërndahet në dyqan për çdo rimbursim për produktet e blera në çdo dyqan të ZARA-s, ose (ii) që do të dërgohet me email në adresën e klientit i cili ka bërë blerjen me Kartë, për çdo kthim të produkteve të blera .

Metodat e rimbursimit e dhënë në vijim janë kusht thelbësor dhe si i tilla, ato konsiderohen të jenë shprehimisht të pranuar me rastin e blerjes dhe / ose përdorimit të Kartës.

9. Karta nuk ka datë skadimi.
10. Karta është instrument mbajtës. Mbajtësi i saj do të jetë përgjegjës për përdorimin dhe ruajtjen e Kartës. Karta nuk do të zëvendësohet në rast të vjedhjes, humbjes ose dëmtimit të saj. Megjithatë, ZARA mund ta zëvendësojë Kartën në rast të ndryshimit të formatit të saj.
11. Kur Karta virtuale blihet nëpërmjet www.zara.com/xk, ZARA nuk do të jetë përgjegjëse për mosmarrjen ose vonesën në marrjen e kësaj Kartë nga marrësi i saj i synuar për arsye jashtë kontrollit të ZARA-s, duke përfshirë ndër të tjera: (i) mangësitë ose prishjet e linjave/sistemeve të telekomunikacionit, (ii) vonesa në transmetimin e informacionit ose të dhënave ose humbja e informacionit ose e të dhënave që mund të ndodhë në cilëndo nga rrethanat e parashikuara në shkronjën (i) më sipër; (iii) pasaktësia e të dhënave të marrësit të Kartës virtuale të ofruara nga blerësi i Kartës; (iv) mosdorëzimi i Kartës në adresën e postës elektronike të dhënë, ose (v) fakti që e-maili i dërguar nga ZARA konsiderohet të jetë email “spam” ose i padëshiruar.
12. Kartat e marrura përmes çfarëdo mjeti të paligjshëm, do të jenë të pavlefshme dhe nuk do të përdoren për të blerë produkte, as çmimi i tyre nuk do të rimbursohet.
13. Karta nuk do të përdoret për qëllime reklamimi ose promovimi të produkteve apo shërbimeve të tregtuara nga ndonjë palë e tretë, përveç lëshuesit të Kartës, përveç nëse pëlqimi paraprak me shkrim është dhënë nga lëshuesi i Kartës.
14. Blerja / përdorimi i Kartës nënkupton pranimin e plotë të këtyre kushteve, të cilat i janë vënë në dispozicion të konsumatorit me blerjen e Kartës, dhe të cilat gjithashtu janë në dispozicion në secilin dyqan të ZARA-s dhe në www.zara.com/xk.